

Çfarë dijmë në vërtetë rreth të drejtës në pronë?

Analizë mbi njohuritë dhe qëndrimet e grave dhe burrave të komunave të Kaçanikut, Vitisë e Shtërpçës rreth të drejtës në pronë dhe trashëgimi



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA



Çfarë dijmë në të vërtetë rreth të drejtës në pronë?

Analizë mbi njohuritë dhe qëndrimet e grave dhe burrave të komunave të
Kaçanikut, Vitisë e Shtërpcës rreth të drejtës në pronë dhe trashëgimi

Shkurt 2018

Çka dijmë në të vërtetë rreth të drejtës në pronë?

Çka dijmë në të vërtetë rreth të drejtës në pronë?

Mbështetur nga



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERICKOG NARODA



Ky raport u mundësua me përkrahjen bujare të popullit amerikan përmes Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar – USAID. Raporti është zhvilluar në kuadër të projektit “Gratë: Agjente për të drejtat pronësore” që është implementuar nga Kosova - Women 4 Women, përmes Programit Angazhimi për Barazi – E4E, i financuar nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar - USAID dhe realizuar nga Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim - ATRC.

Përmbajtja është përgjegjësi e organizatës Kosova - Women 4 Women dhe nuk pasqyron doemos pikëpamjet e USAID apo të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

Përgatitur nga

Vesa Reznici-Pallaska me kontributin e Liridona Sijarina

Kontribuesit tjerë

Iliriana Gashi, Besa Kasneci dhe Drita Morina

Originali është i shkruar në gjuhën shqipe.

Publikuar nga

Kosova – Women 4 Women

rr. Kosturi, Arbëria III, 10000 Prishtinë, Kosovë

Tel. +37745266267

Copyright © 2017 by Kosova – Women 4 Women. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, ruhet në ndonjë sistem për ruajtje, apo të bartet, në çfarëdo forme apo me çfarëdo mjeti, qoftë mekanik, me fotokopje, incizim apo në mënyra të tjera, pa lejen paraprake me shkrim të botuesit.

Çka dijmë në të vërtetë rreth të drejtës në pronë?

Çka dijmë në të vërtetë rreth të drejtës në pronë?

Përmbajtja

PËRMBAJTJA.....	5
PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME.....	7
TË GJETURAT KRYESORE DHE REKOMANDIMET	8
METODOLOGJIA	10
TË GJETURAT NGA ANALIZA E TË DHËNAVE	11
1. Anketa me respondentet gra.....	11
Të dhënat përgjithshme rreth respondentëve grave	11
Njohuritë e grave mbi të drejtën në pronë e trashëgimi	18
Qëndrimet e grave mbi të drejtën në pronë e trashëgimi	23
2. Anketimi me respondentë burra.....	25
Të dhënat e përgjithshme rreth respondentëve burra	25
Njohuritë e burrave rreth të drejtës në pronë e trashëgimi.....	30
Qëndrimet e burrave rreth të drejtës në pronë e trashëgimi.....	34
3. Dallimet në mes të burrave dhe grave.....	36
Krahasime në të dhënat e përgjithshme	36
Dallimi në mes të njohurive të grave dhe burrave.....	41
Dallimi në mes të qëndrimeve të grave dhe burrave	47
LISTA E GRAFIKONEVE	50

Çka dijmë në të vërtetë rreth të drejtës në pronë?

Përmbledhje e përgjithshme

Ky raport është përgatitur në kuadër të projektit ‘Gratë si agjente për të drejtat pronësore’ që është implementuar nga Kosova – Women 4 Women. Synimi i këtij projekti ka qenë edukimi i grave dhe burrave në viset rurale lidhur me të drejtat e grave në pronë dhe trashëgimi, duke i fuqizuar gratë për ta kërkuar këtë të drejtë. Ky projekt ka synuar të punoj 300 gra dhe 150 burra në komunat Kaçanik, Viti dhe Shtërpçë, kryesisht nga viset rurale. Duke e synuar një numër kaq të madh të përfituesve ka qenë e përshtatshme që anketimet me ta dhe të dhënat nga anketimet të jenë tregues dhe të jenë mësim për intervenime të ardhshme. Me qëllim të plotësimit të të dhënave nga anketat janë organizuar edhe dy diskutime në grupe fokusi në dy komunat përfituese, që të gjitha të përmbledhura në këtë raport.

Qëllimi i këtij raporti është që të analizohet profili, njohuritë dhe qëndrimet e grave dhe burrave nga viset rurale të komunave Kaçanik, Viti dhe Shtërpçë lidhur me të drejtën në pronë dhe trashëgimi. Raporti fillon me një përmbledhje të gjetjeve dhe rekomandime. Pjesa kryesore e raportit prezanton të gjeturat nga të dhënat e anketimeve të kombinuara me konkluzionet nga diskutimet në grupet e fokusit dhe kjo pjesë është e organizuar në tri pjesë. Pjesa e parë analizon rezultatet e anketimeve me gra (lidhur me pozitën e tyre me pronë dhe trashëgimi, njohuritë e tyre dhe qëndrimet) dhe duke i krahasuar disa nga këto rezultate me statistikën e përgjithshme në nivel të Kosovës dhe disa të ndara sipas komunave. Pjesa e dytë i analizon rezultatet nga anketa me burrat. Pjesa e fundit e këtij kapitulli i krahason rezultatet e anketimeve me burra e gra e që të gjitha të plotësuar me konkluzionet nga diskutimet në grupet e fokusit.

‘Çka dijmë në të vërtetë rreth të drejtës në pronë’ është emri i këtij raporti që tenton t’i elaboroj dhe pasqyroj njohuritë reale të grave dhe burrave në fushat specifike të të drejtës në pronë dhe trashëgimi. Raporti tenton të shikon më thellë se sa vetë-vlerësimi i grave e burrave lidhur me njohuritë e tyre për të drejtat pronësore.

Të gjeturat kryesore dhe rekomandimet

Anketimet e zhvilluara me gra e burra kanë ofruar të dhëna që pasqyrojnë pozitën e grave në gëzimin e të drejtës së tyre në pronë dhe trashëgimi krahasuar me burrat; që pasqyrojnë ambiciet e grave për të ardhmen në këtë fushë; që pasqyrojnë njohuritë e grave rreth të drejtave të tyre krahasuar me burrat si dhe qëndrimet e fshehta që ndonjëherë kanë qenë në kundërshtim me njëra tjetrën.

Të gjeturat kryesore nga anketimet me gra e burra janë:

- 9.8 përqind të grave konsiderojnë se gëzojnë pronë në emrin e tyre krahasuar me 50.5 përqind të burrave të anketuar. Nga numri total i respondentëve 2.5 përqind e grave kanë deklaruar se zotërojnë shtëpi/banesë krahasuar me 40.4 përqind të burrave; 6.5 përqind kanë në pronësi tokë, krahasuar me 28.8 përqind të burrave; rreth 5 përqind e grave zotërojnë automjete, në krahasim me rreth 34.6 përqind të burrave;
- Në mesin e atyre që zotërojnë pronë, shumica e burrave që kanë pronë (rreth 53 përqind) e kanë fituar pronën përmes trashëgimisë, krahasuar me 37 përqind të grave. Dallim ka edhe te prona e përbashkët martesore që te gratë është më e lartë me rreth 38 përqind krahasuar me burrat me rreth 12 përqind;
- Pritjet e grave dhe burrave për të pasur pronë në të ardhmen gjithashtu dallojnë në mënyrën se si do ta fitojnë atë. Përderisa rreth 62 përqind e burrave shpresojnë që të zotërojnë një shtëpi/banesë në të ardhmen, vetëm 30 përqind e grave shpresojnë të njëjtën. Ngjajshëm është edhe me tokë të cilën 65 përqind e burrave shpresojnë ta zotërojnë krahasuar me 25 përqind të grave. Burrat kryesisht shpresojnë ta fitojnë pronën përmes pronës së trashëguar (me rreth 45 përqind të rasteve) dhe duke e blerë pronën vet (me 44 përqind), përderisa vetëm 5 përqind shpresojnë ta fitojnë pronën si pronë e përbashkët martesore. Fitimi i pronës si pronë e përbashkët martesore ka qenë opsioni më i zgjedhur nga ana e grave me rreth 46 përqind. Vetëm 12 përqind e grave shpresojnë ta fitojnë pronën përmes trashëgimisë dhe rreth 38 përqind shpresojnë ta blejnë pronën vet;
- Në përgjithsi gratë kanë treguar më pak njohuri rreth të drejtës pronësore, qoftë duke u përgjigjur në pyetje me ‘nuk e di’, qoftë duke dhënë përgjigje të gabuara. Përderisa 73.5 përqind e burrave e dijnë që ligji i mbështet të drejtat pronësore të grave, të gratë kjo njohuri

Çka dijmë në të vërtetë rreth të drejtës në pronë?

është në mesin e rreth 53 përqind të tyre. Ngjashëm me këtë trend, përrreth 44 përqind e grave besojnë se ligji ju jep më shumë përparësi djemve në dëm të vajzave, krahasuar me rreth 31 përqind të burrave;

- Rreth 65 përqind të burrave kanë njohuri të sakta se sipas ligjit pasuria duhet të ndahet në mënyrë të barabartë në mes të fëmijëve krahasuar me 50 përqind të grave. 18 përqind e grave mendon se ligji parasheh që vajzat të marrin $\frac{1}{4}$ e pasurisë që i ipet djalit, krahasuar me 14 përqind të burrave që mendojnë njëjtë;
- Se prona e blerë gjatë martesës është pronë e përbashkët martesore mendojnë rreth 43 përqind e grave dhe 46 përqind e burrave. Mirëpo, gratë kanë tendencë ta llogarisin pronën që e ka trashëguar bashkëshorti si pronë të përbashkët martesore (me rreth 23.2 përqind të përgjigjeve);
- Përqindja e burrave që mendojnë se prona e përbashkët martesore u takon edhe grave që nuk kanë punuar ndonjëherë arrinë deri në 83.5 përqind të responentëve, përderisa në mesin e grave arrin në 77.7 përqind;
- Rreth 30 përqind e grave mendojnë se gratë heqin dorë nga trashëgimia sepse nuk e dijnë që kanë e këtë të drejtë; ndërsa 75 përqind e burrave dhe 67 përqind e grave pajtohen që gratë heqin dorë për të mos prishur marrëdhënjet me familjen e lindjes;
- Rreth 38 përqind e grave pajtohen plotësisht me mendimin se te familjet që nuk kanë djem nuk duhet tu lihet trashëgimi vajzave për shkak të mos-vazhdimit të mbiemrit të familjes, krahasuar me 11.6 përqind të burrave. Gjithashtu, një përqindje e lartë e grave (40.4 përqind) mendojnë se vajza është mirë të heq dorë nga trashëgimia sepse shtëpia nuk mund të ndahet në shumë pjesë, në krahasim me 24 përqind të burrave.

Rekomandimet që janë nxjerrë dhe motivuar nga këto të dhëna janë:

- Informimi i popullatës së gjërë (me përqëndrim të madh të gratë) lidhur me atë se çfarë është prona; çfarë është trashëgimia; çfarë parashihet sipas legjislacionit në Kosovë lidhur me pronën dhe trashëgiminë; çfarë është prona e përbashkët martesore;
- Ngritja e vetëdijes së popullatës së gjërë lidhur me dallimet në mes të ligjeve zakonore/zakoneve dhe ligjeve të Kosovës që e adresojnë këtë çështje.

Metodologjia

Të gjeturat në këtë raport janë bazuar në anketimet¹ me 290 gra dhe 105 burra nga komunat Kaçanik, Viti dhe Shtërpce si dhe dy diskutime në grupe fokusi me pjesëmarrjës heterogjene në Kaçanik e Viti (duke filluar prej grave dhe burrave të trajnuar, e deri te drejtorët e shkollave, udhëheqësitë e fshatrave, anëtarët e kuvendeve komunale, zyrtarët komunal për barazi gjinore, studentë dhe përfaqësues të të rinjëve). Anketimet janë zhvilluar duke i përdorur pyetsorët e zhvilluar nga KW4W dhe me kontribut nga ATRC, të organizuara në tri pjesë: 1. Informatat e përgjithshme të respondentëve (demografike dhe informata tjera që lidhen me pronë dhe trashëgimi); 2. Njohuritë e pjesëmarrësve rreth të drejtës në pronë dhe trashëgimi; 3. Qëndrimet e respondentëve lidhur me të drejtat e grave në pronë dhe trashëgimi.

Pjesëmarrës të anketimeve kanë qenë përfituesit e projektit (të trajnimeve/sesioneve informuese) që kryesisht kanë ardhur nga viset rurale të të tre komunave përfituese. Të gjithë respondentët e kanë plotësuar pyetsorin në fillim të seancave trajnuese, para ekspozimit në përmbajtje/informata nga trajnimit. Respondentët në mesin e grave kanë qenë kryesisht gra përfituese të trajnimeve të tjera nga ana e KW4W në të kaluarën (kryesisht të trajnimit një-vjeçar të KW4W/WfWI për fuqizim ekonomik dhe social), përderisa në mesin e burrave respondentët janë mobilizuar përmes mënyrave të ndryshme të mobilizimit (përmes anëtareve femra të familjes, përmes drejtorëve të shkollave e përfaqësuesve të fshatrave). Respondentët në mesin e grave kanë qenë prej fshatrave Biqec, Dubravë, Nikaj/Malësi, Doganaj dhe Soponicë (në Kaçanik); Firajë, Brod, Biti, Jazhincë, Brezovicë dhe Sevce (në Shtërpce); dhe Lubishtë, Skifteraj, Sodovinë, Remnik e Sllatinë e Epërme (në Viti). Respondentët në mesin e burrave kanë qenë nga fshatrat Biqec, Elezaj, Doganaj, Dubravë dhe Duraj (në Kaçanik), Brod, Viçë, Firajë e Sevce (në Shtërpce); dhe Skifteraj (në Viti).

¹ Për anketimet me gra dhe burra janë përdorur pyetsorë të ngjashëm me qëllim të krahasimit. Pyetsorët kanë qenë anonim dhe të plotësuar nga vet gratë dhe burrat (me asistencën e asistentëve të monitorimit dhe vlerësimit të KW4W) duke marrë parasysh ndjeshmërinë e temës që e ka adresuar pyetsori


Çka dijmë në të vërtetë rreth të drejtës në pronë?

Të gjeturat nga analiza e të dhënave

1. Anketa me respondentet gra

Të dhënat përgjithshme rreth respondentëve grave

Anketa është zhvilluar me 290 gra të komunave përfituese dhe grupi i grave respondentë varion nga mosha 20-74 vite, me mesatarën e viteve 45. Numri më i madh i respondentëve është arritur në komunën e Shtërpcës me 41 përqind të grave të cilat i janë nënshtruar pyetësorit, pasuar nga Vitia me 33 përqind dhe Kaçaniku me 26 përqind.




Grafikoni 1. Respondentët sipas komunave

Pronësia në mesin e grave duket të jetë shumë e ulët në viset rurale të të tri komunave në të cilat janë zhvilluar anketat. Të pyetura rreth pronësisë dhe a kanë ndonjë pronë në emër të tyre, 90.18 përqind e grave kanë deklaruar se nuk kanë ndonjë pronë në emrin e tyre, ndërsa vetëm 9.8 përqind kanë deklaruar se kanë pronë në emrin e tyre. Ky rezultat është i ngjashëm me shumën e përqindjes së grave që kanë si pronësi shtëpi (5 përqind) dhe tokë bujqësore (4.9 përqind) – sipas Agjencisë së statistikave të Kosovës të vitit 2015². Të ndara sipas komunave përqindja me e lartë e grave që konsiderojnë se kanë pronë në emër të tyre ka qenë në Viti me 12 përqind.


²Agjencia e statistikave të Kosovës. Gratë dhe Burrat në Kosovë 2014-2015. Shihni në <http://ask.rks-gov.net/>

Çka dijmë në të vërtetë rreth të drejtës në pronë?




Grafikoni 2. Përqindja e grave që kanë deklaruar se kanë pronë në emër të tyre – ndarë sipas komunave

Në mesin e atyre që kanë deklaruar se kanë ndonjë pronë, gati gjysma e përgjigjeve kanë qenë se zotërojnë tokë si pasuri, përderisa 24 përqind i kanë konsideruar automjetet si pasuri të tyre dhe 18.9 përqind që e kanë konsideruar shtëpinë si pronë të tyre.



Grafikoni 3. Shpërndarja e përgjigjeve se çfarë konsiderojnë gratë si pronë të tyre


Çka dijmë në të vërtetë rreth të drejtës në pronë?



Në mesin e atyre që kanë deklaruar se kanë pronë në emër të tyre ka qenë shumë e përafërt përqindja e atyre që e kanë fituar atë si pronë e përbashkët martesore (me 38 përqind) dhe atyre që e kanë trashëguar pronën (38 përqind), përderisa 24 përqind prej tyre kanë deklaruar se e kanë blerë pronën vet.


Grafikoni 4. Si e kanë fituar gratë pronën?

Lidhur me ambiciet e grave për të zotëruar ndonjë pronë në të ardhmen – gratë janë pyetur nëse kanë synime të zotërojnë/posedojnë forma të ndryshme të pronës dhe janë pyetur për mënyrën se si ato synojnë ta fitojnë këtë pronë në të ardhmen. Rreth 68 përqind e grave kanë deklaruar se synojnë që të kenë pronë në të ardhmen. Me shpërndarjen e përgjigjeve që janë pranuar nga këto gra në përqindje del se rreth 54 përqind synojnë të kenë prona të paluajtshme në emrin e tyre (shtëpi ose tokë), 25 përqind automjete dhe 18 përqind gjedhe.



Grafikoni 5. Çfarë synojnë gratë të posedojnë në të ardhmen?

Çka dijmë në të vërtetë rreth të drejtës në pronë?




Grafikoni 6. Si synojnë ta fitojnë gratë pronën në të ardhmen?

Sa i përket mënyrës se si synojnë ta fitojnë pronën, pothuajse gjysma e grave (me rreth 46 përqind) kanë deklaruar se shpresojnë ta fitojnë pronën si pronë e përbashkët martesore, pasuar me 38 përqind të grave që kanë deklaruar se do ta blejnë vetë, duke mbetur vetëm 13 përqind prej tyre që kanë shpresa në pronë të trashëguar.


Gratë janë pyetur lidhur me mendimet e tyre rreth gjendjes ekonomike të familjeve të tyre (duke bërë krahasime me familjen ku kanë lindur dhe familjen ku janë martuar) në mënyrë që të kuptohet se si gratë e perceptojnë situatën ekonomike të familjeve të tyre. Rreth 73 përqind e grave janë përgjigjur se familjet e tyre e gëzojnë një mirëqenie ekonomike ‘mesatare’ në familjet ku jetojnë aktualisht (në mesin 91 përqind të respondentëve që janë të martuara) krahasuar me 61 përqind të atyre që i konsiderojnë kushtet ekonomike të familjes së lindjes si ‘mesatare’. Mirëpo, perceptimi i grave se kushtet e ‘mrekullushme’ dhe ‘shumë të mira’ është më i madh për familjen ku ka lindur (me rreth 34 përqind) krahasuar me familjen ku jeton aktualisht (me rreth 17 përqind). Perceptimi i grave se kushtet ekonomike të familjes së lindjes janë më të mira se te familja e saj pas martesës po vërtetohet edhe tek ekstremi tjetër negativ, ku rreth 5 përqind e përgjigjeve konfirmojnë ‘kushtet e dobëta’ ose ‘varfëri’ për gjendjen ekonomike tek familja e lindjes krahasuar me 8.9 përqind të përgjigjeve për familjen ku janë martuar.

Çka dijmë në të vërtetë rreth të drejtës në pronë?



Grafikoni 7. Krahësimi në mes të perceptimit të kushteve ekonomike të familjes së lindjes dhe ku është martuar


Gratë janë pyetur nëse familja e tyre e lindjes e ka përmbyllë procesin e trashëgimisë dhe rreth 31 përqind kanë kaluar nëpër procese të trashëgimisë, përderisa 67 përqind nuk kanë kaluar në këtë proces, dhe rreth 3 përqind nuk dijnë. Kur janë pyetur nëse ka prona në familjen e tyre që janë ende në emër të ndonjë anëtarë të vdekur të familjes – 47.6 përqind e tyre kanë deklaruar se kanë prona në emër të ndonjë personi të vdekur, përcjellë me 43.9 përqind që kanë deklaruar se nuk kanë dhe mbetja e atyre që nuk e dijnë.



Grafikoni 8. A ka kaluar familja e lindjes në proces të trashëgimisë?

Çka dijmë në të vërtetë rreth të drejtës në pronë?

Përreth 88 përqind e atyre që kanë kaluar përmes procesit të ndarjes së trashëgimisë kanë deklaruar se nuk kanë marrë asgjë nga trashëgimia e familjes së tyre të lindjes. Në mesin e tyre 82 përqind kanë hequr dorë nga trashëgimia në favor të vëllezërve, përcjellur më 12 përqind të atyre që kanë qenë të përjashtuar përmes testamentit dhe përreth 5 përqind të atyre që nuk janë raportuar si trashëgimtare.



Grafikoni 9³. Nëse gratë nuk kanë marrë pjesë të ndarjes së trashëgimisë, cila ka qenë arsyeja?


‘Ka mungesë të guximit në mesin e grave sepse ato frikësohen se do të injorohen nga familja ku kanë lindur. Në anën tjetër vëllezërit i dojnë motrat e tyre për interes sepse ato heqin dorë nga trashëgimia. Nëse nuk heqin dorë, nuk ka më dashuri për motra ...’

Diskutimi në grup fokusi – pjesëmarrëse femër

³ Opsionet ‘Nuk e di’ dhe ‘tjetër’ janë përjashtuar nga kalkulimi

Çka dijmë në të vërtetë rreth të drejtës në pronë?

Gratë janë pyetur edhe nëse do ta kishin mbështetjen e bashkëshortëve të tyre për ta kërkuar të drejtën e tyre në trashëgimi. Përreth 50 përqind e respondentëve janë përgjigjur se do ta gëzonin mbështetjen e tyre, ndërsa rreth 32 përqind janë deklaruar se bashkëshortët e tyre nuk do ishin dakord me kërkimin e të drejtës së tyre në trashëgimi. Rreth 18 përqind janë deklaruar se nuk e dinë se si do të ishte reagimi i bashkëshortësve të tyre lidhur me këtë çështje.




Grafikoni 10. A do ta kishin gratë mbështetjen e burrave në kërkimin e së drejtës së tyre në trashëgimi?

Njohuritë e grave mbi të drejtën në pronë e trashëgimi


Perceptimi i përgjithshëm që popullata ka njohuri rreth të drejtës në pronë është hulumtuar përmes këtij studimi që ka synuar ta provoj vërtetësinë e këtij perceptimi duke i pyetur gratë rreth pyetjeve konkrete rreth pronës në përgjithsi dhe trashëgimisë. Ka pasur evidenca që gratë kanë njohuri rreth të drejtës në pronë dhe ato vet deklarojnë se kanë njohuri dhe përmes kësaj ankete ne kemi shikuar se sa në të vërtetë dijnë rreth të drejtës në pronë. Kjo edhe me qëllim të dizajnit të intervenimeve për të ardhmen dhe kampanjave vetëdijesuese që janë më të fokusuara.

Fillimisht gratë janë pyetur lidhur më atë se çka konsiderohet pronë sipas tyre. Një numër i madh i grave e perceptojnë pronën e paluajtshme si pronë, gjegjësisht rreth 70 përqind që i konsiderojnë objektet (shtëpitë, lokalet) si pronë dhe 68 përqind që mendojnë se edhe toka është pronë. Ndërsa kur flitet për bizneset, gjedhet, pajisjet, arin apo të hollat - përqindja e grave që kanë konsideruar se janë pronë bie dukshëm.




Grafikoni 11. Çka konsiderojnë gratë si pronë?

Çka dijmë në të vërtetë rreth të drejtës në pronë?



Kur janë pyetur nëse ligjet i mbështesin të drejtat pronësore të grave në Kosovë – 52.7 përqind e respondentëve gra mendojnë se ligji i mbështetë të drejtat e grave në pronë, përdërisa 28.50 përqind e tyre nuk mendojnë se ligji i mbrojnë të drejtat e tyre pronësore dhe 18.80 përqind të cilat nuk kanë njohuri.

Grafikoni 12. A i mbështesin ligjet në Kosovë të drejtat pronësore të gruas – sipas grave?




Lidhja të cilën gratë e bëjnë kur flitet për ligjin me të drejtën zakonore vjen në shprehje sidomos në përgjigjet e tyre lidhur me atë se a u jep ligji më shumë të drejta djemve në pronë në dëm të vajzave, ku përqindja e grave të cilat janë përgjigjur me pohim është 43.9 përqind të respondentëve, pasuar me 31.7 përqind të tyre që nuk pajtohen me këtë qëndrim dhe 24.4 përqind të atyre që nuk e dijnë.


Grafikoni 13. A i favorizojnë ligjet e Kosovës më shumë djemtë në dëm të vajzave – sipas grave?

Çka dijmë në të vërtetë rreth të drejtës në pronë?

Njëra rreth pyetjeve që ka pasur për qëllim dokumentimin e njohurivë bazike të grave rreth të drejtës në trashëgimi ka qenë e lidhur me ndarjen e pasurisë në mes djemve dhe vajzave të familjes. Rreth 49.4 përqind e grave mendojnë se ligji e parashih ndarjen e barabartë, ndërsa rreth 23 përqind e grave mendojnë se ekziston një ndarje që i diskriminon vajzat në marrjen e trashëgimisë. Gjithashtu rreth 27 përqind e grave nuk kanë njohuri rreth kësaj çështjeje.



Grafikoni 14. Shpërndarja e trashëgimisë sipas ligjeve në Kosovë – sipas grave




Në pyetjen se a është e drejta e grave në pronë e drejtë themelore, 77.6 përqind të respondentëve janë përgjigjur me 'po', pasuar me 17 përqind që nuk mendojnë se kjo e drejtë hynë në kategorinë e të drejtave themelore të njeriut dhe me 5.4 përqind që nuk e dijnë.

Grafikoni 15. A janë të drejtat pronësore të drejta themelore të njeriut – sipas grave?


Çka dijmë në të vërtetë rreth të drejtës në pronë?

Gjithashtu gratë janë pyetur se çka mendojnë se është prona e përbashkët martesore dhe 43.2 përqind e grave e kanë zgjedhur përgjigjen e saktë. Pjesa tjetër e grave nuk e kanë zgjedhur përgjigjen e saktë (rreth 37 përqind) dhe 19 përqind e grave që kanë deklaruar se nuk dijnë. Shihni grafikoni më poshtë me shpërndarjen e përgjigjeve të pranuar nga gratë.



Grafikoni 16. Çfarë është prona e përbashkët martesore – sipas grave?


Gratë gjithashtu janë pyetur nëse ju takon prona e përbashkët martesore nëse ato nuk kanë punuar dhe nëse nuk kanë gjeneruar të ardhura në familje. Rreth 77 përqind e tyre janë përgjigjur saktë duke theksuar faktin se ligji e njeh edhe kontributin e tyre si amvise dhe se prona e përbashkët martesore u takon edhe atyre edhe nëse ato nuk kanë siguruar të ardhura të rregullta për familjet e tyre. Ndërsa një pjesë e grave (rreth 16 përqind) nuk mendojnë se atyre u takon prona e përbashkët martesore nëse nuk kanë kontribuar drejtpërdrejtë përmes të ardhurave në mirëqenien ekonomike, pasuar me 6.2 përqind të grave të cilat nuk dijnë nëse u takon apo jo.



Grafikoni 17. A kanë grate të drejtë në pronë të përbashkët martesore edhe nëse nuk punojnë me pagë – sipas grave?

Çka dijmë në të vërtetë rreth të drejtës në pronë?

Në tentim për të identifikuar arsyet e heqjes dorë nga trashëgimia, i kemi pyetur gratë se pse ‘gratë tjera’ heqin dorë nga e drejta e tyre në trashëgimi. Pasi që gratë e kanë patur mundësinë të zgjedhin më shumë se një mundësi – figura më poshtë i prezenton përqindjet e përgjigjeve që e kanë zgjedhur përgjigjen ‘po’ karshi përgjigjeve ‘jo’. Shpërndarja e ndarë në të djathtë të grafikonit tregon përqindjet e të gjitha përgjigjeve dhe peshën e tyre në përqindje, sipas të cilës arsyeja kryesore e heqjes dorë nga e drejta në trashëgimi në mesin e grave (me 38 përqind të përgjigjeve) është ruajtja e marrëdhënieve të mira me vëllezërit dhe prindërit, pasuar me 20 përqind të përgjigjeve që theksojnë se gratë heqin dorë sepse janë vëllezërit ata që jetojnë me prindërit dhe përkujdesen për ta dhe që janë ata që duhet rrjedhimisht edhe ta trashëgojnë pronën.



Grafikoni 18. Pse heqin dorë gratë nga trashëgimia – sipas grave?

‘Nëse vajzat marrin edukim të mirëfilltë që do t’i ndihmojë ato që ta ndërtojnë vet karrierën e tyre dhe të gjejnë punë të mirë, kjo duhet të jetë e mjaftueshme për to.’

Diskutimi në grup fokusi – pjesëmarrëse femër

Çka dijmë në të vërtetë rreth të drejtës në pronë?

Qëndrimet e grave mbi të drejtën në pronë e trashëgimi


Është kërkuar nga gratë që të vlerësojnë një listë të tetë deklaratave nga ‘shumë e vërtetë’ deri tek ‘aspak e vërtetë’, deklaratat të cilat janë munduar të kapin disa mundësi dhe pozicionime të tyre lidhur me gratë, pronën dhe trashëgiminë. Dy deklaratat që kanë pasur më së shumti konsensus nga gratë kanë qenë se ‘fëmijët do të trashëgojnë pjesë të barabarta pavarësisht gjinisë’ (me 73.4 përqind që e kanë theksuar si ‘shumë e vërtetë’) dhe se ‘gratë nuk dëshirojnë trashëgimi sepse nuk dëshirojnë t’i prishin marrëdhënjet me vëllezër dhe prindër’ (ku 61.7 përqind e kanë theksuar si ‘shumë e vërtetë’). Një tjetër deklaratë ku ka pasur pajtueshmëri në mesin e 57.4 përqind të grave ka qenë me deklaratën se ‘trashëgimia duhet të ndahet në mënyrë të barabartë në mes të motrave dhe vëllezërve, me një hise më të madhe t’iu takojë atyre që jetojnë dhe kujdesen për prindërit’.

Gjithashtu ka mospajtime në mesin e mendimeve të grave të njejta. Përderisa janë 74 përqind të grave që janë pajtuar se trashëgimia duhet të ndahet barabartë në mes të fëmijëve, përqindja e befasishme e rreth 38 përqind të grave që janë pajtuar me deklaratën se ‘në familjet që kanë vetëm vajza - ato nuk duhet ta trashëgojnë pronën sepse nuk do ta përcjellin mbiemrin’ dhe përrreth 40 përqind që pajtohen se ‘gratë duhet të heqin dorë nga prona sepse shtëpia e prindërve është shumë e vogël për tu ndarë në disa pjesë’.


‘Është shumë vështirë që ta ndryshojmë të kaluarën dhe çfarë ka filluar me neve. Mirëpo mundemi me e ndryshu të ardhmen për fëmijët tanë. Duhet të sigurohemi se fëmijët e kuptojnë se janë të barabartë.’

Diskutimi në grup fokusi – pjesëmarrëse femër

Çka dijmë në të vërtetë rreth të drejtës në pronë?



Grafikoni 19. Qëndrimet e grave rreth të drejtës pronësore dhe trashëgimisë (në përqindje) – pjesa I




Grafikoni 20. Qëndrimet e grave rreth të drejtës pronësore dhe trashëgimisë (në përqindje) – pjesa II

Çka dijmë në të vërtetë rreth të drejtës në pronë?

2. Anketimi me respondentë burra


Të dhënat e përgjithshme rreth respondentëve burra

Rezultatet e hulumtimit janë mbledhur në tri komunat (Kaçanik, Viti dhe Shtërpce) në të cilat është zhvilluar projekti. Anketa është zhvilluar me 105 burra dhe mostra ndër burra varion nga mosha 16-76, me mesataret e viteve rreth 39. Numri më i madh i respondentëve është arritur në komunën e Kaçanikut me 61 përqind të burrave të cilat i janë nënshtruar pyetësorit, pasuar nga Vitia me 20 përqind dhe Shtërpca me 19 përqind.



Grafikoni 21. Respondentët sipas komunave

Më shumë se gjysma (50.5 përqind) e respondentëve deklarohen se kanë pronë në emrin e tyre. Në




Grafikoni 22. Çka konsiderojnë burrat si pronë të tyre?

pyetjen për llojin e pronës që zotërojnë 40.4 përqind pohuan se kanë shtëpi në pronësi të tyre, rreth 34 përqind zotërojnë automjete, rreth 29 përqind zotërojnë tokë dhe 20 përqind bagëti/gjedhe.

Çka dijmë në të vërtetë rreth të drejtës në pronë?


Grafikoni poshtë paraqet të njëjtat të dhëna por të shpërndara në përgjigje të burrave dhe asaj se çfarë zotërojnë, sipas të cilave 32.5 përqind e të anketuarve kanë shtëpi, rreth 23.26 përqind e tyre



kanë tokë, mbi 27 përqind automjete personale dhe 16 përqind kanë gjedhe/bagëti. Nëse shikohet shpërndarja e përgjigjeve në përqindje, rezulton se rreth 55 përqind kanë pasuri të patundshme (shtëpi dhe tokë).

Grafikoni 23. Shpërndarja e përgjigjeve se çfarë konsiderojnë burrat si pronë të tyre


Në pyetjen se si e kanë fituar pronën që e kanë deklaruar se kanë, më shumë se gjysma e tyre (53 përqind) kanë deklaruar se pronën e tyre e kanë fituar përmes trashëgimisë, ndërsa pjesa tjetër (rreth 35 përqind) ka pohuar se e ka fituar duke e blerë vetë, ndërsa vetëm 12 përqind kanë pohuar se e kanë fituar si pronë të përbashkët martesore.



Grafikoni 24. Si e kanë fituar burrat pronën?

Çka dijmë në të vërtetë rreth të drejtës në pronë?


Burrat gjithashtu u pyetën lidhur me ambiciet e tyre që të kenë një pronë në të ardhmen. Shpërndarja



e përgjigjeve paraqitet në figurën më poshtë, sipas të cilës rreth 29 përqind e burrave planifikojnë të kenë në posedim të tyre shtëpi, 30 përqind e tyre kanë planifikuar të kenë toka, 25 përqind të tyre synojnë të kenë vetura ndërsa 11 përqind të tyre gjedhe.

Grafikoni 25. Çfarë synojnë burrat të posedojnë në të ardhmen?


Kur janë pyetur se si mendojnë se do ta fitojnë pronën në të ardhmen, përqindja e atyre që kanë deklaruar se mendojnë se do ta fitojnë përmes trashëgimisë ka shënuar 45 përqind e respondentëve. Ndërsa një pjesë e tyre pretendojnë ta fitojnë vetë pronën e tyre duke e blerë. Ndërsa vetëm 5 përqind e burrave të anketuar janë përgjigjur se synojnë ta fitojnë pronën e tyre përmes pronës së përbashkët martesore.



Grafikoni 26. Si synojnë ta fitojnë burrat pronën në të ardhmen?


Çka dijmë në të vërtetë rreth të drejtës në pronë?

Burrat janë pyetur edhe nëse është ndarë pasuria në familjet e tyre. Rreth 24 përqind e burrave kanë deklaruar se e kanë përfunduar procesin e ndarjes së pasurisë.



Grafikoni 27. A ka kaluar familja në proces të trashëgimisë?


Në mesin e atyre tek të cilët është ndarë pasuria rreth 93.8 përqind e respondentëve janë përgjigjur se motrat e tyre nuk kanë marrë hise në trashëgiminë e familjes së tyre, ndërsa vetëm 6.2 përqind e tyre janë përgjigjur se motrat e tyre kanë hise në pronën e cila i takon familjes.



Grafikoni 28. A kanë marrë motrat pjesë në trashëgimi?

Çka dijmë në të vërtetë rreth të drejtës në pronë?

Ndërsa, në listimin e arsyeve për të cilat motrat e respondentëve nuk kanë gëzuar pjesën e tyre të trashëgimisë, sipas burrave del se arsyeja kryesore (me rreth 58.6 përqind të përgjigjeve) është se ato kanë hequr dorë vetë nga trashëgimia. Përdërisa 23 përqind e respondentëve kanë deklaruar se nuk kanë motra, ndërsa 3.4 përqind kanë thënë se nuk ka qenë në vullnetin e prindërve për t'u lënë pronë vajzave të tyre.




Grafikoni 29. Arsyet se pse motrat nuk e kanë gëzuar pjesën e trashëgimisë

‘Është paragjykim në mesin e grave që nëse ato e marrin hisen e trashëgimisë nga familja e tyre kjo sjellë fat të keq.’

Diskutim në grup fokusi – pjesëmarrës mashkull

Njohuritë e burrave rreth të drejtës në pronë e trashëgimi


Ngjashëm sikurse gratë, edhe burrat i kemi anketuar rreth njohurive të tyre rreth të drejtës pronësore në përgjithësi, disa pyetje për pronën e përbashkët martesore, të drejtat e grave mbi pronën dhe trashëgiminë. Ndër pyetjet e para për burra ka qenë se çka konsiderojnë ata pronë. Perceptimi se prona konsiston në pronë të paluajtshme është në përgjithësi e bashkëndarë edhe tek burrat, duke qenë se një pjesë e madhe e burrave kanë deklaruar se pronë mund të konsiderohen objektet/shtëpitë me 84.3 përqind që e kanë pohuar këtë, dhe toka me 92.2 përqind që e kanë pohuar këtë. Ndërsa përqindja e burrave të cilët mendojnë se pronë mund të quhet edhe prona e luajtshme bie dukshëm me 57.8 përqind të respondentëve që i pohojnë automjetet si pronë, 48.1 përqind gjedhe, 46.1 përqind bizneset, 32.4 përqind ari dhe 31.3 përqind të holla.



Grafikoni 30. Çka konsiderojnë burrat si pronë?

Në pyetjen më specifike se a mendojnë burrat se ligji i mbështetë të drejtat pronësore për gratë në Kosovë, 73. përqind e tyre janë përgjigjur se ligji i mbështet të drejtat pronësore të grave, me 12.7 përqind të respondentëve të cilët kanë deklaruar se ligji nuk i mbështetë ato dhe rreth 13.7 përqind të atyre të cilët nuk dijnë për këtë aspekt.


Çka dijmë në të vërtetë rreth të drejtës në pronë?



Ndërsa të pyetur se a mendojnë që ligji i jep përparësi djemve kur flitet për trashëgimi në dëm të vajzave - 31.1 përqind janë përgjigjur pozitivisht, ndërsa pjesa dërmuese mendon se ligjet nuk janë diskriminuese sa i përket gjinisë kur flitet për pronë dhe të drejtën trashëgimore (me 57.3) përqind të të anketuarve. Ndërsa 11.7 përqind është deklaruar se nuk kanë njohuri për këtë.


Grafikoni 31. A i favorizojnë ligjet e Kosovës më shumë djemtë në dëm të vajzave – sipas burrave?

Mendimet e lartshënuara pasqyrohen edhe në pyetjen se si përcaktohet me ligj ndarja e pasurisë ndër vajza dhe djem, ku shumica e respondentëve (65.3 përqind) kanë deklaruar se ndarja e pasurisë përcaktohet në mënyrë të barabartë si për djemtë edhe për vajzat. Ndërsa 14.3 përqind mendojnë se vajzat sipas ligjit gëzojnë $\frac{1}{4}$ e pasurisë që e merr djali, ndërsa 5.1 përqind kanë deklaruar se ligji e përcakton që vajzat të marrin $\frac{1}{2}$ e pasurisë që e merr djali. Ndërsa 15.3 përqind kanë deklaruar se nuk kanë njohuri se si rregullohet me ligj ndarja e pasurisë në terma gjinore.



Grafikoni 32. Shpërndarja e trashëgimisë sipas ligjeve në Kosovë – sipas burrave


Çka dijmë në të vërtetë rreth të drejtës në pronë?



Një pjesë dukshëm më e madhe e burrave të cilët janë përgjigjur në pyetjen se a janë të drejtat pronësore të grave të drejta themelore të njeriut e kanë pohuar këtë gjë. Rreth 88.1 përqind e respondentëve janë përgjigjur se ajo është e drejtë themelore, me 5.9 përqind të burrave që nuk e konsiderojnë si të drejtë themelore çështjen e gëzimit të pronës dhe me 5.9 përqind të tyre të cilët nuk kanë njohuri.

Grafikoni 33. A janë të drejtat pronësore të drejta themelore të njeriut – sipas burrave?


Burrat gjithashtu i kemi pyetur se çka konsiderojnë si pronë të përbashkët martesore. Rreth 46 përqind e burrave janë përgjigjur saktë, përderisa 22 përqind prej tyre e shohin atë si pronë të trashëguar nga familja gjatë martesës dhe 13 përqind prej tyre mendojnë që është pronë e trashëguar nga bashkëshorti/ja. Pjesa tjetër (rreth 8 përqind) e respondentëve e shohin atë si pronë e cila është blerë nga bashkëshortët para martesës, 8.5 përqind e shohin si pronë të trashëguar gjatë martesës dhe rreth 11 përqind të respondentëve të cilët nuk e dijnë.



Grafikoni 34. Çfarë është pronë e përbashkët martesore – sipas burrave?

Çka dijmë në të vërtetë rreth të drejtës në pronë?

Ngjashëm me gratë, kjo anketë ka synuar të zbulojë mendimin e burrave se pse gratë në përgjithësi heqin dorë nga trashëgimia e tyre. Grafikoni në vijim paraqet përqindjen e përgjigjeve ‘po’ dhe ‘jo’ për secilin opcion dhe në të djathtë në formë të shpërndarjes së përgjigjeve në përqindje. Burrat mendojnë që arsyeja kryesore përse gratë heqin dorë nga trashëgimia është se kjo mund t’i dëmtojë raportet e tyre me vëllezërit dhe prindërit e tyre (me 33.94 përqind të përgjigjeve dhe 75.5 përqind të burrave që e kanë zgjedhur këtë opcion). Dy arsye tjera me përqindje më të madhe janë se ‘prona e familjes është shumë e vogël për t’u ndarë’ dhe se ‘vëllezërit jetojnë me prindërit dhe kujdesen për ta dhe rrjedhimisht atyre u takon trashëgimia’.



Grafikoni 35. Pse gratë heqin dorë nga e drejta e tyre në trashëgimi – sipas burrave?

Qëndrimet e burrave rreth të drejtës në pronë e trashëgimi


Anketa gjithashtu u përpoq të matë qëndrimet e burrave ndaj pozitës së grave në pronë dhe trashëgimi. Burrat pajtoheshin me njëri-tjetrin më së shumti në dy qëndrime, i pari me rreth 76 përqind e atyre që pajtohen se ‘fëmijët e tyre do të trashëgojnë pronën në mënyrë të barabartë pa marrë parasysh gjininë’, përderisa e dyta me 66.3 përqind e atyre që nuk mendojnë se ‘nëse familja ka vajza, atyre të mos iu takojë trashëgimia...’. Pothuajse gjysma e burrave (47.1 përqind) nuk pajtohen me faktin se ‘motrat nuk duhet të kërkojnë hise pasi që ato e kanë hisen e tyre të bashkëshortët e tyre’. Një përqindje e ngjashme (42.4 përqind) nuk mendojnë se ‘motrat duhet të heqin dorë nga hisja që të mos i rrezikojnë marrëdhëniet me vllazërit dhe prindërit’, përderisa 41.3 përqind pajtohen që fëmijët të cilët kujdesen për prindërit duhet të trashëgojnë gjithë pronën.

Qëndrimet e burrave lidhur me trashëgiminë për motra ishin pozitive në përgjithsi, ku një përqindje e vogël (11 përqind-18 përqind) mendojnë se vajza nuk e trashëgon mbiemrin prandaj të familjet që kanë vetëm vajza nuk duhet tu lihet trashëgimi.


‘Unë kam planifikuar që vajza ime t’i ketë të njejtat përfitime sikurse djemt e mi (një banesë, një veturë), sidoqoftë do të zhgënjehesha shumë në të në qoftë se ajo do t’i kërkonte ato apo hisen e saj.

Diskutimi në grup fokusi – pjesëmarrës mashkull

Çka dijmë në të vërtetë rreth të drejtës në pronë?



Grafikoni 36. Qëndrimet e burrave rreth të drejtës pronësore dhe trashëgimisë (në përqindje) – pjesa I




Grafikoni 37. Qëndrimet e burrave rreth të drejtës pronësore dhe trashëgimisë (në përqindje) – pjesa II

3. Dallimet në mes të burrave dhe grave

Krahasime në të dhënat e përgjithshme

Respondentët gra dhe burra iu kanë nënshtruar pyetësorëve të ngjashëm me qëllim krahasimi. Ka shumë dallime midis burrave dhe grave, siç pritej, i pari është në përqindjen e atyre që konsiderojnë se kanë pronë në pronësi të tyre.


Nga 50.5 përqind e burrave të cilët gëzojnë të paktën një lloj të pronës, përkundër kësaj gratë janë dukshëm më pak të prirura të deklarohen si pronare të ndonjë pronësie, me vetëm 9.8 përqind të tyre të cilat kanë deklaruar se gëzojnë pronë në emrin e tyre.



Grafikoni 38. Dallimi në mes të grave e burrave se a posedojnë pronë

Çka dijmë në të vërtetë rreth të drejtës në pronë?

Dallimi zmadhohet edhe më kur shqyrtohen llojet e pronësisë që burrat dhe gratë gëzojnë. Përderisa shtëpitë janë në pronësi të burrave në 40 përqind të rasteve, vetëm 2.5 përqind e grave kanë deklaruar se kanë shtëpi/banesë në pronësi të tyre. Një dallim më i vogël është për tokën, me 28.8 përqind e respondentëve burra karshi 6.5 përqind të grave.




Grafikoni 39⁴. Dallimi në mes të grave e burrave lidhur me llojin e pronave që i posedojnë

Ndër gratë dhe burrat që zotërojnë ndonjë pronë, ekziston një dallim se si e kanë fituar atë. Përderisa në mesin e grave 38 përqind prej tyre e kanë fituar pronën përmes trashëgimisë, në mesin e burrave kjo përqindje është mbi 52 përqind. Një dallim i ngjashëm është për pronën e blerë vetë nga 24 përqind e grave dhe 35 përqind e burrave. Një dallim në kontrast është për pronën e fituar si një pronë e përbashkët martesore, në të cilën gratë kanë udhëheqjen me gati 38 përqind krahasuar me 12 përqind të burrave. Teknikisht kjo përqindje e fundit duhet të jetë në një nivel të ngjashëm për gratë dhe burrat.


⁴ Ky grafikoni i prezanton përqindjet e përgjigjeve 'po' të mundësive të ndryshme në këtë pyetje me përgjigje të shumëfishta

Çka dijmë në të vërtetë rreth të drejtës në pronë?



Grafikoni 40. Dallimi në mes grave e burrave lidhur me mënyrën se si e kanë fituar pronën

Sa i përket ambicjeve të grave dhe burrave që të kenë një pronë në të ardhmen, diferenca në përqindje është përsëri shumë e madhe në mes tyre. Përderisa blerja e një shtëpie në të ardhmen ishte një objektiv për 62 përqind të burrave, e njëjta ishte një synim për vetëm 20.3 përqind të grave. Dallimi akoma më i madh ishte në qëllimin për të blerë tokë. Duke qenë një pyetje me shumë zgjedhje, një numër i respondentëve përzgjedhi më shumë se një opsion. Shihni grafikun më poshtë për më shumë detaje:




Grafikoni 41⁵. Dallimi në mes të grave e burrave lidhur me llojin e pronave që synojnë t'i posedojnë

⁵ Sërish kjo nuk është shpërndarja e përgjigjeve në përqindje. Është prezantimi i përqindjeve të përgjigjeve 'po' të mundësive të ndryshme në këtë pyetje me përgjigje të shumëfishta

Çka dijmë në të vërtetë rreth të drejtës në pronë?


Ndër ata që synojnë të kenë një pronë në të ardhmen ka dallime të mëdha midis grave dhe burrave dhe se si ata planifikojnë ta fitojnë këtë pronë. Ngjashmëria më e madhe është për 44.16 përqind të burrave dhe 38.24 përqind të grave që planifikojnë të blejnë vet pronën e tyre, e cila ende ka një diferencë prej 6 përqind. Një ndryshim i madh është në mundësinë e blerjes së pronës në të ardhmen



si një pronë e përbashkët martesore, ku vetëm 5 përqind e burrave e mendonin atë si një opsion, ndërkohë që ishte opsioni me përqindje më e lartë për gratë me rreth 46 përqind. E kundërta është për mundësinë e marrjes së çdo pasurie të ardhshme përmes trashëgimisë, e cila u përzgjodh nga rreth 45 përqind e burrave dhe vetëm rreth 12 përqind e grave.

Grafikoni 42. Dallimi në mes të grave e burrave se si synojnë ta fitojnë pronën në të ardhmen


Një nga pyetjet që i kemi pyetur gratë dhe burrat ishte nëse ata kontribuojnë në ndonjë mënyrë për mirëqenjen ekonomike të familjes. Ky ndryshim midis grave dhe burrave nuk ishte aq i madh sa pritej, ku 85.7 përqind e burrave kontribuojnë me të ardhura në familje, ndërsa 75 përqind e grave



pretenduan të njëjtën gjë. Ne po e atribuojmë këtë përqindje të lartë të grave në faktin se shumica e atyre grave ishin përfituese paraprake të KW4W të cilat kanë kaluar nëpër trajnime sociale që vlerësojnë punën e grave në shtëpi, punën në bujqësi dhe bujqësinë në një vlerë monetare.

Grafikoni 43. Dallimi në mes të grave e burrave se a kontribuojnë me të ardhura në familje

Kur u pyetën për hollësitë në fushat që ata kontribuojnë në ekonominë familjare, ka dallime midis grave dhe burrave. Përderisa 37.41 përqind e burrave kontribuojnë me të ardhura të rregullta, vetëm rreth 12 përqind e grave bëjnë të njëjtën gjë. Një ndryshim i ngjashëm në përqindje ishte për mundësinë e sjelljes së të ardhurave përmes bujqësisë në të cilën gratë udhëheqin me 48.54 përqind krahasuar me vetëm 28.78 përqind të burrave. Sjellja e të ardhurave përmes bujqësisë është një mundësi tjetër në të cilën gratë kanë një përqindje më të lartë prej 12.41 përqind karshi burrave me 5 përqind. Dy opsione të tjera nuk ishin të njëjta për gratë dhe burrat, por që ne i kemi shtuar si burim tjetër potencial i të ardhurave. Përderisa gratë punojnë në punë artizanale (6.5 përqind) apo në shoqatat e grave (19.4 përqind) - burrat punojnë në ndërtimtari (15.3 përqind) ose në arsim (9.85 përqind).




Grafikoni 44. Dallimi në mes të grave e burrave se si kontribuojnë ata në mirëqenjen e familjes

Çka dijmë në të vërtetë rreth të drejtës në pronë?

Dallimi në mes të njohurive të grave dhe burrave

Të dhënat nga ky hulumtim tregojnë se njohuritë e përgjithshme të burrave mbi pronën dhe pozitën e grave në pronë dhe trashëgimi janë më të larta në krahasim me gratë. Pyetja e parë ishte në atë që ata e konsiderojnë si një pronë. Përderisa 88.30 përqind e burrave e kanë zgjedhur shtëpinë/ndërtesën/lokalin si një opsion, 70 përqind e grave e kanë zgjedhur të njëjtën. Një përqindje e ngjashme e grave gjithashtu e kanë zgjedhur opsionin 'tokë', ndërsa 92 përqind e burrave e kanë zgjedhur të njëjtën. Shihni grafikun⁶ e mëposhtëm me përqindjet e grave dhe burrave që zgjedhin secilin opsion.



Grafikoni 45. Dallimi në mes të grave dhe burrave lidhur me atë se çka konsiderojnë pronë


'Prona e luajtshme është gjithashtu një pronë që mund të trashëgohet. Njerëzit kanë tendencë të harrojnë kwtw si një mundësi ...'

Diskutimi në grup fokusi – pjesëmarrës mashkull

⁶ Ky grafik nuk paraqet shpërndarjen e përgjigjeve në përqindje. Është prezantim i përqindjeve të përgjigjeve 'po' për përgjigje të mundshme në këtë pyetje me mundësi të më shumë se një përgjigje

Çka dijmë në të vërtetë rreth të drejtës në pronë?

Të pyetur nëse mendojnë se ligji i mbrojnë të drejtat pronësore të grave, burrat kanë tendencë ta ndajnë normativen nga realja duke qenë se një pjesë e konsiderueshme e tyre (73.5 përqind)




mendojnë se ligji është në favor të së drejtës së grave në pronë. Kjo shifër bie për gratë, duke rezultuar kështu në vetëm 52.7 përqind të grave që mendojnë se ligji i mbështet të drejtat e tyre pronësore. Ndërsa 18.8 përqind të grave janë përgjigjur se nuk e dijnë dhe 13.7 përqind të burrave që janë përgjigjur njësoj.

Grafikoni 46. Dallimi në mendimet e grave dhe burrave nëse ligji i mbështet të drejtat pronësore të grave

Edhe pse ligjet shkruhen për t'u kuptuar nga popullata e përgjithshme, duket se nuk ka interes në mesin e popullatës për të kërkuar ligjet dhe për t'i lexuar ato.

Diskutimi në grup fokusi – pjesëmarrëse femër

Ngjashëm me pyetjen e mësipërme, kemi pyetur respondentët nëse mendojnë se ligji në Kosovë u jep më shumë të drejta trashëgimie djemve duke dëmtuar kështu vajzat. Përsëri më shumë gra (43.9




përqind) mendojnë se ligji diskriminon femrat/vajzat kur bëhet fjalë për të drejtat e trashëgimisë, ndërsa 31.1 përqind e burrave mendojnë të njëjtën gjë. Numri i grave që nuk kanë njohuri është rreth 24 përqind në krahasim me 11.7 përqind të burrave.

Grafikoni 47. Dallimi në mendimet e grave dhe burrave nëse ligji iu jep më shumë të drejta djemve në pronë në dëm të vajzave

Çka dijmë në të vërtetë rreth të drejtës në pronë?

Gjatë testimit të njohurive të grave dhe burrave se si duket shpërndarja e trashëgimisë sipas ligjeve ekzistuese në Kosovë, përsëri më shumë burra (65 përqind) kanë dhënë përgjigje të saktë në krahasim me pothuajse gjysmën e grave. Pothuajse 19 përqind e grave kanë zgjedhur opsionin që 'vajzat kanë të drejtë në 1/4 e asaj që trashëgojnë djemtë', përderisa vetëm 14.3 përqind e burrave kanë zgjedhur të njëjtën përgjigje. Një përqindje pothuajse e ngjashme e grave dhe burrave (rreth 5 përqind) mendojnë se ligji parashikon që vajza të marrë 1/2 e asaj që e trashëgojnë djemtë. Përsëri, përqindja e grave që kanë zgjedhur opsionin 'Nuk e di' është më e lartë (rreth 27 përqind) sesa në mesin e burrave (me rreth 15 përqind).




Grafikoni 48. Dallimi në mendimet e grave e burrave se si ligji e parasheh ndarjen e trashëgimisë

‘Gratë kanë dhe nuk kanë njohuri mbi këtë çështje. Ato mendojnë që dijnë, por vetëm kur i pyet për hollësi ato nuk dijnë të përgjigjen’

Diskutimi në grup fokusi – pjesëmarrëse femër

Çka dijmë në të vërtetë rreth të drejtës në pronë?

Burrat dhe gratë mbrojnë pozicion të ngjashëm kur u pyetën se a mund të konsiderohet e drejta pronësore e grave si e drejtë themelore e njeriut. Rreth 88.1 përqind e burrave mendojnë se të drejtat



pronësore janë pjesë e të drejtave themelore të njeriut, e pasuar nga 77.6 përqind e grave që mendojnë të njëjtën gjë. Përqindje që pasohet nga 17 përqind e grave që nuk e dijnë nëse të drejtat në pronë hyjnë apo jo në të drejtat themelore të njeriut dhe 5.9 përqind të burrave që e mendojnë të njëjtën gjë.

Grafikoni 49. Dallimi në mendimet e grave e burrave nëse e drejta në pronë është e drejtë themelore e njeriut


Në pyetjen lidhur me pronën e përbashkët martesore, një përqindje më e lartë e burrave (46 përqind) kishte përgjigjen e saktë në krahasim me gratë (me rreth 43 përqind). Ndërsa gratë kanë tendencë të vlerësojnë se prona e trashëguar nga bashkëshorti mund të konsiderohet si një pronë e përbashkët martesore me 23.2 përqind, ndërsa vetëm 13 përqind e kanë parë këtë si një përgjigje të saktë. Në anën tjetër, niveli i burrave që perceptojnë pronën e përbashkët martesore si pasuri që trashëgohe gjatë martesës është më i lartë (me 22 përqind) sesa gratë (me 8.5 përqind). Gratë kanë tendencë ta ngatërrojnë më shumë pronën e përbashkët martesore dhe pronën e trashëguar të burrit.

‘Gratë ngatërrojnë pasurinë e trashëguar me pronën e përbashkët martesore dhe kjo po shkakton shumë konteste në regjistrimin e pronës së përbashkët martesore.’

Diskutimi në grup fokusi – pjesëmarrëse mashkull


Çka dijmë në të vërtetë rreth të drejtës në pronë?

Rreth 19 përqind e grave nuk e dijnë se çka mund të konsiderohet pasuri e përbashkët martesore krahas 11 përqind të burrave.



Grafikoni 50. Dallimi në mendimet e grave e burrave se çka konsiderojnë ata si pronë të përbashkët martesore

Pjesa më e madhe e burrave dhe grave mendojnë se grave u takon prona e përbashkët martesore




edhe nëse ato gjatë martesës nuk kanë kontribuar asnjëherë me të ardhura të rregullta në mirëqenien ekonomike të familjes. Kështu, përqindja e burrave që mendojnë prona e përbashkët u takon edhe grave që nuk kanë punuar ndonjëherë arrinë deri në 83.5 përqind të respondentëve dhe 77.7 përqind të grave responente.

Grafikoni 51. Dallimi në mendimet e grave e burrave nëse grave ju takon prona e përbashkët martesore edhe nëse nuk kanë punuar me pagë

Çka dijmë në të vërtetë rreth të drejtës në pronë?

Burrat dhe gratë tregojnë mendime të ngjashme përkitazi me arsyet përse gratë heqin dorë nga e drejta e tyre trashëgimore. Ekzistojnë tri opsione me dallime më të mëdha se 10 përqind në mes të grave dhe burrave. Opsioni 'prona e familjes është shumë e vogël për t'u ndarë' është përzgjedhur nga afro 38 përqind e burrave në krahasim me 23 përqind të grave. Rreth 30 përqind e grave thanë se gratë 'nuk janë të vetëdijshme se kanë hise në trashëgimi' krahasuar me rreth 16 përqind të burrave që mendojnë të njëjtën gjë. Opsioni që u përzgjedh nga shumica e të anketuarve ishte se gratë heqin dorë nga trashëgimia sepse 'nuk duan të prishin marrëdhëniet e tyre me vëllezërit dhe prindërit'. Kjo u zgjodh si opsion nga 75.5 përqind e burrave dhe 67.4 përqind e grave.



Grafikoni 52⁷. Dallimi në mendimet e grave e burrave se pse gratë heqin dore nga trashëgimia

⁷ Ky grafik nuk paraqet shpërndarjen e përgjigjeve në përqindje. Është prezantim i përqindjeve të përgjigjeve 'po' për përgjigje të mundshme në këtë pyetje me mundësi të më shumë se një përgjigje


Dallimi në mes të qëndrimeve të grave dhe burrave

Burrat dhe gratë tregojnë disa qëndrime të ngjashme kur flitet për fëmijët e tyre dhe ndarjen e trashëgimisë në mënyrë të barabartë. 76 përqind e burrave dhe 73 përqind e grave pajtohen plotësisht se do duhet të ndahet pasuria në mënyrë të barabartë në mes të vajzave e djemve. Një tjetër ngjashmëri e përgjigjeve midis grave dhe burrave është në deklaratën se ‘fëmijët që kujdesen dhe jetojnë me prindërit duhet të trashëgojnë gjithë pasurinë’ me 43.5 përqind të grave që e vlerësojnë këtë deklaratë si shumë të vërtetë dhe 41.3 përqind të burrave.

Fillimisht, 37 përqind e grave pajtohen që nëse një familje ka vetëm vajza, trashëgimia nuk duhet t’iu përkasë atyre, pasi ato nuk do të vazhdojnë të njëjtin mbiemër, krahasuar me 11.6 përqind të burrave që mendojnë kështu. Gjithashtu një përqindje e lartë e grave (40.4 përqind) mendojnë se ‘është e përshtatshme për një vajzë që të heqë dorë nga prona e saj sepse shtëpia nuk mund të ndahet në shumë pjesë’, krahasuar me 24 përqind të burrave. Një ndryshim tjetër i madh në qëndrimet është perceptimi se pse gratë tërhiqen nga trashëgimia e tyre. Përderisa rreth 62 përqind e grave pajtohen se nuk duan një pjesë të trashëgimisë në mënyrë që të mos i shkatërrojnë marrëdhënjet me vëllezërit dhe prindërit, vetëm rreth 19 përqind e burrave pajtohen me këtë.


Dy grafikonet më poshtë janë më të detajuara për shpërndarjen e përgjigjeve të grave dhe burrave, duke pasur dy deklarata që janë të ndryshme për burrat në krahasim me gratë.

Çka dijmë në të vërtetë rreth të drejtës në pronë?



Grafikoni 53. Dallimi në qëndrimet e grave dhe burrave – pjesa I (të prezentuara në përqindje)

Çka dijmë në të vërtetë rreth të drejtës në pronë?



Grafikoni 54. Dallimi në qëndrimet e grave dhe burrave – pjesa II (të prezentuara në përqindje)

Lista e grafikoneve

Grafikoni 1. Responentet sipas komunave	11
Grafikoni 2. Përqindja e grave që kanë deklaruar se kanë pronë në emër të tyre – ndarë sipas komunave.....	12
Grafikoni 3. Shpërndarja e përgjigjeve se çfarë konsiderojnë gratë si pronë të tyre	12
Grafikoni 4. Si e kanë fituar gratë pronën?	13
Grafikoni 5. Çfarë synojnë gratë të posedojnë në të ardhmen?	13
Grafikoni 6. Si synojnë ta fitojnë gratë pronën në të ardhmen?.....	14
Grafikoni 7. Krahësimi në mes të perceptimit të kushteve ekonomike të familjes së lindjes dhe ku është martuar	15
Grafikoni 8. A ka kaluar familja e lindjes në proces të trashëgimisë?.....	15
Grafikoni 9. Nëse gratë nuk kanë marrë pjesë të ndarjes së trashëgimisë, cila ka qenë arsyeja?	16
Grafikoni 10. A do ta kishin gratë mbështetjen e burrave në kërkimin e së drejtës së tyre në trashëgimi?.....	17
Grafikoni 11. Çka konsiderojnë gratë si pronë?.....	18
Grafikoni 12. A i mbështesin ligjet në Kosovë të drejtat pronësore të gruas – sipas grave?	19
Grafikoni 13. A i favorizojnë ligjet e Kosovës më shumë djemtë në dëm të vajzave – sipas grave?	19
Grafikoni 14. Shpërndarja e trashëgimisë sipas ligjeve në Kosovë – sipas grave	20
Grafikoni 15. A janë të drejtat pronësore të drejta themelore të njeriut – sipas grave?	20
Grafikoni 16. Çfarë është prona e përbashkët martesore – sipas grave?	21
Grafikoni 17. A kanë grate të drejtë në pronë të përbashkët martesore edhe nëse nuk punojnë me pagë – sipas grave?.....	21
Grafikoni 18. Pse heqin dorë gratë nga trashëgimia – sipas grave?	22
Grafikoni 19. Qëndrimet e grave rreth të drejtës pronësore dhe trashëgimisë (në përqindje) – pjesa I.....	24
Grafikoni 20. Qëndrimet e grave rreth të drejtës pronësore dhe trashëgimisë (në përqindje) – pjesa II	24
Grafikoni 21. Responentët sipas komunave	25
Grafikoni 22. Çka konsiderojnë burrat si pronë të tyre?	25

Çka dijmë në të vërtetë rreth të drejtës në pronë?

Grafikoni 23. Shpërndarja e përgjigjeve se çfarë konsiderojnë burrat si pronë të tyre.....	26
Grafikoni 24. Si e kanë fituar burrat pronën?.....	26
Grafikoni 25. Çfarë synojnë burrat të posedojnë në të ardhmen?	27
Grafikoni 26. Si synojnë ta fitojnë burrat pronën në të ardhmen?	27
Grafikoni 27. A ka kaluar familja në proces të trashëgimisë?	28
Grafikoni 28. A kanë marrë motrat pjesë në trashëgimi?	28
Grafikoni 29. Arsyet se pse motrat nuk e kanë gëzuar pjesën e trashëgimisë.....	29
Grafikoni 30. Çka konsiderojnë burrat si pronë?.....	30
Grafikoni 31. A i favorizojnë ligjet e Kosovës më shumë djemtë në dëm të vajzave – sipas burrave?	31
Grafikoni 32. Shpërndarja e trashëgimisë sipas ligjeve në Kosovë – sipas burrave.....	31
Grafikoni 33. A janë të drejtat pronësore të drejta themelore të njeriut – sipas burrave?	32
Grafikoni 34. Çfarë është prona e përbashkët martesore – sipas burrave?	32
Grafikoni 35. Pse gratë heqin dorë nga e drejta e tyre në trashëgimi – sipas burrave?	33
Grafikoni 36. Qëndrimet e burrave rreth të drejtës pronësore dhe trashëgimisë (në përqindje) – pjesa I.....	35
Grafikoni 37. Qëndrimet e burrave rreth të drejtës pronësore dhe trashëgimisë (në përqindje) – pjesa II	35
Grafikoni 38. Dallimi në mes të grave e burrave se a posedojnë pronë	36
Grafikoni 39. Dallimi në mes të grave e burrave lidhur me llojin e pronave që i posedojnë	37
Grafikoni 40. Dallimi në mes të grave e burrave lidhur me mënyrën se si e kanë fituar pronën.....	38
Grafikoni 41. Dallimi në mes të grave e burrave lidhur me llojin e pronave që synojnë t'i posedojnë	38
Grafikoni 42. Dallimi në mes të grave e burrave se si synojnë ta fitojnë pronën në të ardhmen... ..	39
Grafikoni 43. Dallimi në mes të grave e burrave se a kontribuojnë me të ardhura në familje.....	39
Grafikoni 44. Dallimi në mes të grave e burrave se si kontribuojnë ata në mirëqenjen e familjes.	40
Grafikoni 45. Dallimi në mes të grave dhe burrave lidhur me atë se çka konsiderojnë pronë	41
Grafikoni 46. Dallimi në mendimet e grave dhe burrave nëse ligji i mbështet të drejtat pronësore të grave.....	42
Grafikoni 47. Dallimi në mendimet e grave dhe burrave nëse ligji iu jep më shumë të drejta djemve në pronë në dëm të vajzave	42

Grafikoni 48. Dallimi në mendimet e grave e burrave se si ligji e parasheh ndarjen e trashëgimisë	43
Grafikoni 49. Dallimi në mendimet e grave e burrave nëse e drejta në pronë është e drejtë themelore e njeriut.....	44
Grafikoni 50. Dallimi në mendimet e grave e burrave se çka konsiderojnë ata si pronë të përbashkët martesore	45
Grafikoni 51. Dallimi në mendimet e grave e burrave nëse grave ju takon prona e përbashkët martesore edhe nëse nuk kanë punuar me pagë	45
Grafikoni 52. Dallimi në mendimet e grave e burrave se pse gratë heqin dore nga trashëgimia	46
Grafikoni 53. Dallimi në qëndrimet e grave dhe burrave – pjesa I (të prezentuara në përqindje) .	48
Grafikoni 54. Dallimi në qëndrimet e grave dhe burrave – pjesa II (të prezentuara në përqindje)	49

ÇIKAT LINDIN N'SHPI T'VET!